

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Data: 15/01/2019 Nr.020-12
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendim Nr.70-2018 mbi miratimit të propozimit të komunës për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për realizimin e planit rregullues urban

I miratuar më datë: 28/12/2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08/01/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Gazmend Muhaxheri, gradonačelnik opštine Peć Islam Hysaj, predsedavajući Skupštine opštine Peć	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar administracije lokalne samouprave Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja nadgledanje opština, MALS	Dana: 15.01.2019. Br.020-12
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Peć	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.70-2018 o usvajanju predloga opštine za razmenu opštinske nepokretne imovine sa privatnom svojinom radi realizacije urbanog regulacionog plana.
Usvojena dana: 28.12.2018. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 08.01.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenih akta opštine, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravne efekte.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA

OPŠTINA PEÇ

Administrimi i Pushtetit Lokal
Lokale Samiuprave i Administracije
of Local Government Administration

08.10.2018
-01-020-12

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër:463/01-158704, datë: 28. Dhjetor 2018.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenin 11 të Ligjit për ndryshim në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.04/L-144, si dhe nenit 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Nr.09-8103 dt.29.09.2008, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private të pronarit Nexhmedin Zhara nga Peja, me Rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt.28. Dhjetor 2018, miaz:

V E N D I M

Nr. 70/2018

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN

I. MIRATOHET propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e personit fizik, e më qellim të formimit të rrugës në Pejë.

II. Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës komunale në një pjesë të ngastrës kadastrale 609 PSH e KK Pejë, sipërfaqen prej 240 m² që ka sipërfaqen totale prej 4666 m² ZK Carraver, në këmbim me sipërfaqen prej 142 m² të ngastrës kadastrale 380/4 që ka sipërfaqen prej 269 m² ZK Carraver, pronë private e z.Nexhmedin (Emin) Zhara nga Peja, pasi që sipërfaqja prej 142 m² të këtij pronari është paraparë ndërtimi i rrugës, si interes publik.

III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlersimin e pronave të paluajtshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyres për Vlersimin e pronës së Paluajtshme pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.



KRYESUESI I KUVENDIT
Dr.Islam Husaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDITIST DHE PLANIFIKIMIT HAËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611090-00609-0

Nimni i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 01-562-18
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 27.11.2018 - 13:28
Komuna / Opština / Municipality: Pejë / Peč / Pejë
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: CARRAVËR / CEROVERHE / CARRAVËR
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Pejë / Peč / Pejë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71611090-00609-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Drushkerore / Imovina / Socially owned Land		4666			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësi të adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
DONJA MALA/DONJA DONJA DONJA MALA		DONJA MALA		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trentho koriscenja parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja Povërshna Area (m ²) (m ²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rruge E Pakategor/Nekategorisani/Pur/Uncategorized/Road		4666

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri i Imer Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësi të e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	D.S.OPSHTE NARODNA IMOVINA PUTEVI	KCID1610106	PEJE / PEC / PEJE /			1/1		



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Carravër

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71611090-00609-0	Parcelë / Parcela / Parcel	4666,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:5000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 03.12.2018

Koha/ Vreme/ Time: 10:38:21

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MIEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611090-00380-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 01-562-18
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 27.11.2018 - 13:28
Komuna / Opština / Municipality: Pejë / Peč / Pejë
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: CARRAVËR / CEROVERHE / CARRAVËR
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: Pejë / Peč / Pejë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Namri i njësise kadastrale Broj kadastrske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Azurirano Updated
P-71611090-00380-4	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina Privately owned Land		269	2-1988		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostri adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
ÇUÇANE/ÇUÇANE/ÇUÇANE		ÇUÇANE		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta korisçenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno korisçenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Bujqësore/Polljoptivredno/Agriculture	Kullësor/Pashnjac/pasture	Kullësor E Klases 3/Pashnjak 3 Klase/3rd Class Pasture	269

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postial Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drazavina / single possessor	ZHARA NEXHMEDIN (EMIN)	KCID1611739	PEJË / PEÇ / PEJË /			1/1	2-1988	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Carravër

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71611090-00380-4	Parcelë / Parcela / Parcel	269,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 03.12.2018

Koha/ Vreme/ Time: 10:39:24

Nënshkrimi/Polpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktori/Director

Nënshkrimi/Polpis/Siganture:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEÇ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE

PËR/ZA/TO:	Z. Edmond Shala- Drejtori i Drejtoratit për Çështje Pronoro - Juridike
NGA/OD/FROM:	Mirjeta GJ. Rizvanalli – Arkitekte njësia për planifikim urban, DUMM – K. K. Pejë
CC:	Dr.sc.Rajan Arapi – Drejtor i DUMM
REFERENCË:	08-350-157202
DATË/A:	05.12.2018
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Njoftim

I nderuar

Në kërkesën e Juaj me nr.08-350-157202 të datës 03.12.2018 kërkontë informacion se çka parashifet me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Zhvillimor Komunal në ngastrat kadastrale nr.380-4 në Z.K.Carrver, K.K.Pejë, Ju njoftojmë se:

- Ngasatrat kadastrale të cekur më lartë janë pjesë e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal të miratuar me nr.01-350-4999 datë 14.05.2007.
- Bazuar në shfrytëzimin e tokës sipas Planin Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal si dhe Planit Rregullues Urban "Puhovc - Jarinë" është me destinim rrugë.
- Zgjerimi i rrugës egzistuese është në interes të komunitetit me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe mirëqenies sociale në atë zonë.

Ju faliminderit

Shtojcë:

Ortofoto

Pjesë nga Plani Rregullues Urban " Puhovc - Jarinë"



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEÇ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
REDINE



Fig.1.Ortofoto




Fig.2.Pjesë nga Plani Rregullues Urban "Puhovc - Jarinë"



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Drejtorija për çështje pronsoro-juridike
Nr.15-463- LP 154/2018
Peje më 29.11.2018

PROCESVERBAL MBI DEGJIMIN VERBAL

I përpiluar me dt. 29.11.2018, në zyrët e Drejtorisë për çështje pronsoro-juridike të Komunës së Pejes, në çështjen e procedurës administrative lidhur me interesin publik me qëllim të realizimit të Planit zhvillimor Komunal i bëhet propozimi për këmbimin e pronës e cila gjëndet në ngastren kadastrale, të pronarit privat Nexhmedin Zhara nga Peja, pala prezanton:

Prezentojnë:

PALA :
Nexhmedin (Emin) Zhara

PERSONI ZYRTAR
Osman Kollqaku

Fillon në ora 13h

Drejtorija për çështje pronsoro-juridike është duke zhvilluar procedurë administrative lidhur me këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës për interes publik prandaj propozon që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës komunale në një pjesë të ngastrës kadastrale 609 PSH e KK Pejë, sipërfaqen prej 240 m², që ka sipërfaqen totale prej 4666 m² ZK Carraver, në këmbim me sipërfaqen prej 142 m² të ngastrës kadastrale 380/4 që ka sipërfaqen prej 269 m², ZK Carraver, pronë private e Nexhmedin Zhara nga Peja, pasi që sipërfaqja prej 142 m² të këtij pronari është paraparë ndërtimi i rrugës, si interes publik


Këto prona hynë në procedurë të këmbimit mirpo vlersimin ligjor për këtë këmbim do ta bëjë Zyrja për Vlersimin e paluajtëshmërisë në kuadër të Ministrisë për Buxhet e Financa. Lidhur me këtë këmbim Drejtorija për çështje pronsoro-juridike ka ftuar z.Nexhmedin Zhara nga Peja, për dëgjim verbal në mënyrë që të deklarohet lidhur me zgjedhjen e çështjes së parashtruar, në seancë është paraqitur z.Nexhmedin Zhara dhe pas konsultimeve dhe njoftimit me propozimin për zgjedhjen e çështjes në prezencë të zyrtarit të kësaj Drejtorije Osman Kollqakut, deklararon:

Jam i vetdijshëm se kjo pjesë e pronës sime është e nevojshme për realizimin e projektit për formimin e rrugës si interes publik, prandaj neve na duhet të bëjmë një zgjedhje rreth kësaj, pra e pranojmë variantën e këmbimit të pronës me pronë komunale .Ju po na


ofroni pronën komunale në një pjesë të ngastrës kadastrale 609 PSH e KK Pejë, sipërfaqen prej 240 m² ZK Carraver, në këmbim me sipërfaqen prej 142 m² të ngastrës kadastrale 380/4 që ka sipërfaqen prej 269 m², ZK Carraver që është pronë e imja. Zyra e Vlersimit do të vlersoj se a janë ekuivalente apo jo këto prona ku eventualisht cila pjesë paraqitet me vlerë më të madhe, pala tjetër do ta bënë kompensimin në të holla. Prandaj e pranoj këmbimin e pronës së Komunës me pronën time që do të bëhet sipas vlersimit nga ana e Zyrës së Vlersimit të Ministrisë së Financave, duke shpresuar se ata do ta bëjnë një vlersim real sipas çmimit të tregut.

Më nuk kam çka të deklaroj lidhur me këtë çështje.

P a l a
Nexhmedin Zhara



Personi zyrtar
Osman Kollqaku





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
KK PEJË

Konformë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Pejës, Kryetari i Komunës, z.Gazmend Muhaxheri më datën 05.Dhjetor 2018 pas shqyrtimit të propozimit të Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike për këmbimin e pronave në mes te komunës dhe z.Nexhmedin (Emini) Zhara nga Peja, për formimin dhe ndërtimin e rrugës në Pejë si interes publik, merr këtë.

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë, Propozimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore Juridike për këmbimin e pronave në mes te komunës dhe z.Nexhmedin (Emini) Zhara nga Peja, për formimin dhe ndërtimin e rrugës në Pejë si interes publik.


Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike, Drejtorati të KK Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa, dhe
- Arhivës

I.nr. 463/01-158704/2018

Pejë: 05.Dhjetor 2018


Gazmend Muhaxheri
Kryetari i Komunës
Komuna e Pejës